

FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

KAFEINE NATRIUM BENZOAT

Tretësisë për injeksion – (96 mg + 104 mg) / 1 ml (20%)
(Kafeinë anhidër, Benzoat natriumi)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

- Çfarë është Kafeine natrium benzoat dhe përse përdoret
- Përpara se të merrni Kafeine natrium benzoat
- Si ta merrni Kafeine natrium benzoat
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Kafeine natrium benzoat
- Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË KAFEINE NATRIUM BENZOAT DHE PËRSE PËRDORET

Kafeina është një lëndë që nxit sistemin nervor qendror. Ajo frenon enzimën fosfodiesterazë dhe ka efekt antagonist në receptorët qendrorë të adenosinës. Në sistemin nervor qendror ajo vepron kryesisht në qendrat e larë dhe jep një gjendje pagjumësie duke shtuar shpejtësinë dhe thellësinë e frymëmarrjes. Veprimi i saj nxitës në qendrën medulare vazomotorë dhe veprimi inotrop pozitiv në miokard kompensohen nga efekti vazodilatator periferik në arteriolat, kështu që ajo ka efekt të dobët në presionin e gjakut. Veprimi diuretik i kafeinës është më i dobët se ai i teofilinës. Kafeina mund ta rrisë përthithjen e ergotaminës dhe ndonjëherë kombinohet me këtë të fundit për trajtimin e migrenës. Për të rritur tretshmërinë e kafeinës, ajo kombinohet me benzoatin e natriumit dhe kështu përftohet benzoati sodik i kafeinës, i cili përdoret në trajtë të tretësirave për injeksion.

Kafeina shpërndahet mirë në organizëm. Ajo kalon në sistemin nervor qendror dhe në përshtymë, në përqëndrime të ulëta ajo kalon edhe në qumështin e gjirit. Ky bar duhet të jepet vetëm nën vëzhgimin direkt të mjekut.

Kafeine natrium benzoat indikohet si:

- analeptik i frymëmarrjes dhe i qarkullimit të gjakut, kryesisht gjatë sëmundjeve me temperaturë të lartë dhe sëmundjeve infektive, si edhe gjatë helmimeve.

Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Kafeine natrium benzoat për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë Kafeine natrium benzoat.

2. PËRPARA SE TË MERRNI KAFEINE NATRIUM BENZOAT

Mos merrni Kafeine natrium benzoat në qoftë se keni:

- mbindjeshmëri ndaj kafeinës ose alkaloidëve të tjera ksantinike;
- mbindjeshmëri ndaj ndonjërit nga përbërësit e tjerë të tretësirës për injeksion;

- hipertension arteror të rëndë;
- glaukomë.

Duhet të mënjanohet përdorimi i këtij bari tek të porsalindurit sepse benzoati i natriumit mund të shkaktojë ikter. Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, këshillohuni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna.

Tregoni kujdes të veçantë me Kafeine natrium benzoat

Kafeina duhet përdorur me kujdes në të sëmuret me: hipertiroidizëm, hipertension, aritmi kardiake ose sëmundje të tjera kardiovaskulare (p.sh. insuficiencë kardiake kongjестive), çrregullime të funksionit të mëlçisë, alkoolizëm kronik, sëmundje kronike të mëlçisë, hipoksi të rëndë.

Marrja e barnave të tjera

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Kafeine natrium benzoat. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Kafeine natrium benzoat në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit. Amiodaroni mund të ndërveprojë me kafeinën duke frenuar metabolizmin e saj hepatic, kurse izoniazidi mund t'i frenojë enzimën oksiduese në mëlçi dhe kështu ta dëmtojë jashtëqitjen e kafeinës. Kërkoni këshillën e mjekut ose të farmacistit nëse njëkohësisht me Kafeine natrium benzoat merrni edhe barnat e përmendura më sipër.

Marrja e Kafeine natrium benzoat me ushqim dhe pije

Nuk ka të dhëna të mjaftueshme.

Shtatzënia dhe ushqimi me gj

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni të ngeleni shtatzënë ose nëse jeni duke ushqyer foshnjën me qumësht gjiri.

Kafeina e kalon placentën dhe sekretohet në qumështin e gjirit, kështu që nuk këshillohet të merret si nga gratë shtatzëna sepse ndikon në rritjen e fetusit, ashtu edhe nga nënat që ushqejnë me gjë foshnjën, sepse mund të shkaktojë irritim ose pagjumësi tek foshnjën.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Nuk ka të dhëna.

3. SI TA MERRNI KAFEINE NATRIUM BENZOAT

Gjithmonë, Kafeine natrium benzoat merret sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj. Në qoftë se ndjeni që efektet e Kafeine natrium benzoat janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj. Kafeine natrium benzoat mund të përdoret në doza individuale si më poshtë: dozat mesatare janë 100 – 200 mg që injektohen me kujdes të veçantë në venë.

Në rast nevojë, injeksionet mund të përsëriten.

Doza maksimale ditore nuk duhet të kalojë 1 g.

Pyesni mjekun tuaj për këshillë në qoftë se nuk jeni i sigurt për kohëzgjatjen e trajtimit.

Në qoftë se keni marrë më shumë Kafeine natrium benzoat

Në qoftë se keni marrë më shumë Kafeine natrium benzoat se sasia që duhet të merrni, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se harroni të merrni Kafeine natrium benzoat

Në qoftë se harroni të merrni një dozë, merrni dozën pasardhëse kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj. Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar. Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFekte ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore! Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre. Efektet anësore më të mundshme që mund të vihen re janë: të përziera, të vjella, dhimbje abdominale, diarree, pagjumësi, dhimbje koke, marrje mendsh, ankth dhe palpitacione. Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI KAFEINE NATRIUM BENZOAT

Mbajeni larg fëmijëve!

Mos e përdorni Kafeine natrium benzoat pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim.

Mos e ruani në temperaturë mbi 25°C!

Ruajeni në paketimin original për ta mbrojtur nga drita dhe lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Kafeine natrium benzoat – Tretësisë për injeksion

Lëndët vepruese janë kafeinë anhidër dhe benzoat natriumi.

Çdo ampulë 1 ml përmban 96 mg kafeinë anhidër dhe 104 mg benzoat natriumi.

Përbërësit e tjerë janë: EDTA-natriumi, hidroksid natriumi, acid klorhidrik mund të shtohet për rregullim pH, ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit

Kuti me 10 ampula dhe kuti me 100 ampula (përdorim spitalor).

Shpjegues i ikonave ilustruese në paketim:



Merret vetëm me recetë e mjekut.



Përmbajtja.



Kujdes.



Tretësisë për injeksion.

Mbajtësi i autorizimit të tregtimit dhe prodhuesi:



PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u formulau për herë të fundit në Dhjetor 2012.

